



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ
SKENDERAJ

Nr.
No. 01-463/01-0051806/23
Data.
Data. 4.11.2023



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 2, shkronja d), nenin 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 24 dhe 25 par. 1, 2, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshëm të Komunës, nenin 29 par. 1, 2, 4, 5 dhe 6 si dhe nenin 31 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 84 par. 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, duke u bazuar ne Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025, si dhe Harta Zonale e Komunës së Skenderaj 2020-2028, nenin 14 paragrafin 1, 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, sipas vendimit të kuvendit të komunës së Skenderajt për shpalljen të interesit publik Nr.01-463/01-0027465/23, të datës 01.06.2023, Raporti të vlerësimit të MFPT-së (Departamentit të tatimit në pronë) Nr.735-2/2023 të datës 20.09.2023, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën **30.10.2023** miratoi këtë:

V E N D I M

(Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik/Juridik, **Halil (Mustaf) Hoxhaj**)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi me Nr.02-463/01-0053485/23, të datës 16.10.2023, Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik/juridik **Halil (Mustaf) Hoxhaj**.

Neni 2

Me këtë vendimi, prona e paluajtshme në pronësi të Komunës, ngastra me Nr.699-2, me sipërfaqe prej **271m²**, të ndarë nga sipërfaqja e përgjithshme prej **11232m²**, Zona Kadastrale Skenderaj;

KËMBEHET: Me pronën e paluajtshme të **Halil (Mustaf) Hoxhaj**, ngastrën Nr.582-1, me sipërfaqe **271m²**, Zona Kadastrale Skenderaj.

Neni 3

Qëllimi i këmbim të pronës së paluajtshme të lartcekur bëhet për interes publikë përkatësisht për realizimin e projektit “**Ndërtimi i Tregut të gjelbër në qytetin e Skenderajt**”

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, nën mbikëqyrje të Kryetarit të Komunës

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb-faqen e komunës.

Këtij vendimi i bashkëngjiten: Vendimi i kuvendit të komunës së Skenderajt për shpalljen të interesit publik me Nr.01-463/01-0027465/23, të datës 01.06.2023, Certifikatat e pronësisë, Kopja e planit, Raporti të vlerësimit të MFPT-së, Dëshmi mbi sigurimin e mjeteve financiare, konfirmimi dhe konstatimi nga Kryetari i Komunës nga DGJKP, dhe Pëlqimi Urbanistikë rreth ndërtimit të Tregut të gjelbër në Komunën e Skenderajt me Nr.06-351/01-0054412/23, i datës 23.10.2023.

Vendimi i Dërgohet:

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit,
- 1x1 DGJKP-së,
- 1x1 DUMA-së,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Dosjes.

